



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina

Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d e Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/2008), dispozitave të nenit 7 të Ligjit nr. 04/L-010 për bashkëpunim ndërkomunal, nenit 5 të Rregullores nr. 09/2013 për nxitjen e bashkëpunimit ndërkomunal, dhe dispozitave të nenit 34, paragrafi 34.1, pika d e Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 - 391, të dt. 25.02.2010, Kuvendi i Kryeqytetit, në mbledhjen e mbajtur më 25.07.2022, miratoi këtë

V E N D I M
PËR NISMËN E BASHKËPUNIMIT NDËRKOMUNAL

I.

MIRATOHET Vendimi për nismën e Kryetarit të Komunës së Prishtinës për bashkëpunim ndërkomunal.

II.

Bashkëpunimi ndërkomunal do të zhvillohet mes Komunës së Prishtinës dhe Komunës së Obiliqit, në lidhje me realizimin e projektit të ngrohjes diellore "Solar4Kosovo".

III.

Autorizohet Kryetari i Komunës për të filluar konsultimet me Komunën si në pikën II të këtij Vendimi, për përgatitjen e propozim marrëveshjes, për bashkëpunim ndërkomunal.

IV.

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KRYEQYTETIT
01-024/02-177566/22, më 26.07.2022

KRYESUESI I KUVENDIT
Fehmi Kupa

